



**KONTRATE E SHITBLERJES**  
**(KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR)**

Ne Tirane, ne zyren e noterise, ne rrugen "Ismail Qemali" P.27/1, sot me date 3/12/04, para meje noter Agim Xh.Robo paraqiten personalisht, palet kontraktuese me cilesite e meposhteme:

**SHITESI: Irfan Hysenbelliu**, biri i Hasanit, dl.08.04.1959, banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha" pll.8, nr.pasaporte 1762730 me cilesine e Ortakut te Vetem te shoqerise "EURO-TIRANA STUDIO" sh.p.k.

**BLERESI: Dalan Bijo**, biri i Fejzos, dl.01.08 1952, banues ne Tirane, rruga "Myslym Shyri" Pll.130/1, me nr.pasaportes 0625847.

Te dy me zotesi te plote juridike e per te vepruar qe me vullnetin e tyre te lire kerkuan redaktimin e aktit noterial te shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "**EURO-TIRANA STUDIO**"sh.p.k.

Me vendim gjyqesor nr.27.656 date 26.04.2002 ne Regjistrin Tregetar, eshte regjistruar si person juridik shoqeria "**EURO - TIRANA STUDIO**"sh.p.k. Me vendim gjyqesor nr.27.656/1 date 02.03.2004, Ortak I Vetem zoterues ne 100% te kuotave te kapitalit themeltar eshte Z.Irfan Hysenbelliu, me cilesine e shitesit ne kete Kontrate.

Me vendim nr. 2 date 3/12/2004, Ortaku i Vetem ne perputhje me kompetencat e tij sipas ligjit 7638 date 19.11.1992 ka vendosur: Shitjen e pjeseshme te kuotave te tij ne kapitalin themeltar tek Z.Dalan Bijo. Sipas ketij vendimi hartohet edhe Kontrata noteriale e shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

**PERMBAJTJA E KONTRATES:**

**SHITESI:**

Ortaku i Vetem Z.Irfan Hysenbelliu zoterues ne 100% te kuotave te kapitalit themeltar (i percaktuar ne vlere 100.000 leke sipas Statutit dhe Akt themelimit) i shtet **BLERESIT** Z.Dalan Bijo kuotat e tij zoteruese prej 10% me nje vlere prej 10.000 leke.

**BLERESI:** Z. Dalan Bijo pranon blerjen e kuotave zoteruese mbi kapitalin themeltar ne pjesen prej 10% te Ortakut te Vetem Z.Irfan Hysenbelliu me nje vlere prej 10.000 leke.

Palet kontraktuese deklarojne shlyerjen e vlefes se shitjes.

Me nenshkrimin nga palet dhe vertetimin nga noteri te kesaj Kontrate Z.Irfan Hysenbelliu humbet pronesine ne 10% te kuotave te kapitalit themeltar, pronesi e cila fitohet kundrejt shperblimit te vleres nga Z. Dalan Bijo me cilesine e Ortakut te Ri te shoqerise "**EURO-TIRANA STUDIO**"sh.p.k. me te drejta dhe detyrime ne raport me % e kuotave te blera.

Sa me siper kontrata e shitblerjes u redaktua ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", nenit 39 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".Kontrata iu lexohet paleve me ze te larte.

Palet kontraktuese deklarojne se e kuptojne permbajtjen e saj dhe nenshkruajne ne fund pa asnje verejtje.

Une noteri qe redaktova kontraten e shitblerjes ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe pasi e gjej aktin ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.

## PALET

**SHITESI**

**Irfan HYSENBELLIU**

*Irfan Hysenbelliu*  
*[Signature]*

**BLERESI**

**Dalan BIJO**

*Dalan Bijo*  
*[Signature]*  
2004

**NOTER**

